



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PROGRAMEVE KOMBËTARE

THIRRJE
PËR PROJEKT - PROPOZIME NË KUADËR TË
PROGRAMEVE KOMBËTARE TË KËRKIMIT
SHKENCOR PËR VITIN 2024
(PKKZH DHE PTI)

18 Janar, 2024

Kjo është një thirrje për propozime për projekte të kërkimit shkencor e financuar nga “Programi i financimit të kërkimit shkencor, menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit - AKKSHI”, për vitin 2024.

I. Baza Ligjore

Kuadri rregullator për këtë Program financimi të AKKSHI-së është përcaktuar në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr.97/2023 “Për buxhetin e vitit 2024”

Vendimin Nr.607, datë 31.08.2016 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit”.

Thirrja është në përputhje me Programin Vjetor të Punës 2024 të AKKSHI-së.

Buxheti për financimin e projekteve të PKKZH dhe PTI është miratuar me “Vendim të Bordit të Administrimit të AKKSHI-se, nr. 1 datë 18.01.2024 “Për alokimin e buxhetit të AKKSHI-së për vitin 2024”

II. Fushat Prioritare

Thirrja mbulon fushat prioritare të kërkimit shkencor si më poshtë:

- Biodiversiteti dhe Mjedisi
- Bujqësia, Ushqimi dhe Bioteknologjia
- Shëndetësia dhe shkencat mjekësore
- Sistemet dhe Teknologjitë e Informacionit
- Shkencat Sociale dhe Albanologjike
- Uji dhe Energjia

Në përputhje me fushat e sipërpërmendura, do të kenë prioritet projektet që do të kenë në fokus të tyre tematika që adresojnë Inovacionin, Energjinë dhe Turizmin

III. Qëllimi i thirrjes

Thirrja është e hapur për aplikime për:

A. Projekte Kombëtare të Kërkim Zhvillimit (PKKZH)

B. Projekte të Teknologjisë dhe Inovacionit (PTI), (bashkëpunimi i IAL-ve me biznesin)

1. Qëllimi i thirrjes është mbështetja e veprimtarisë së kërkimit shkencor në fushat prioritare, përmes financimit me grante të projekteve në kuadër të programeve kombëtare, të propozuara nga kërkues shkencorë në Institucionet e Arsimit të Lartë ose institucione të tjera që kanë në objektin e veprimtarisë së tyre kërkimin shkencor.
2. Objektivat e thirrjes janë:
 - i. Të mbështesë me grante projekte kërkimore të cilësisë së lartë që mundësojnë rritje të performancës së kërkuesëve dhe institucioneve

shqiptare të kërimit shkencor në përputhje me standardet e Zonës Evropiane të Kërimit;

- ii. Të mbështesë projekte kërkimore që kanë në fokus fushat prioritare veçanërisht energjinë dhe turizmin;
- iii. Të mbështesë projekt propozime që vijnë si bashkëpunim i universitetit me biznesin të cilat adresojnë përmiresime në teknologji, procese dhe produkte, nëpërmjet inovacionit.

IV. Institucionet që kanë të drejtë të aplikojnë

Në kuadër të programeve kombëtare, kanë të drejtë të aplikojnë për financim të PKKZH dhe PTI, Institucionet e Arsimit të Lartë të përcaktuara si të tilla në Ligjin Nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Neni 4, pika 4, që zhvillojnë kërkim shkencor si dhe institucionet publike e jopublike, që kanë për objekt të veprimtarisë kërkimin shkencor (VKM 607 4/a).

V. Buxheti, financimi dhe kohëzgjatja

1. Buxheti në dispozicion të kësaj thirrje është buxheti i AKKSHI-së për vitin 2024, në zërin buxhetor “Fonde për shkencën”.
2. Në varësi të shtrirjes kohore të aktivitetit të kërimit shkencor, projektet do të jenë afatshkurtëra dhe afatmesme. Ndërsa financimi i tyre do të përcaktohet nga tipologjia e projektit.
 - a) Për projektet e kërimit shkencor (PKKZH dhe PTI) **afatshkurtëra**, me kohëzgjatje deri në **9 muaj**, **vlera maksimale e financimit do të jetë deri në 3,000,000 lekë**.
 - b) Për projektet e kërimit shkencor (PKKZH dhe PTI) **afatmesme**, me kohëzgjatje deri në **18 muaj**, **vlera maksimale e financimit do të jetë deri në 5,000,000 lekë**.

VI. Kriteria të përgjithshme për aplikim

1. Aplikimi për projektin e propozuar duhet të bëhet nga një IAL ose Institucion tjetër sipas përcaktimeve në pikën IV “Institucionet që kanë të drejtë të aplikojnë”¹;
2. Aplikimet duhet të jenë në përputhje me fushat prioritare dhe sipas kërkesave të udhëzuesve të PKKZH dhe PTI (<http://nasri.gov.al/drejtoria-e-programeve-kombetare-2/>);
3. Projekt – propozimi duhet të përmbajë vetëm veprimtari që lidhen me kërkimin shkencor, duke përfshirë aktivitete siç mund të jenë: trajnimet, përkthimet, ngritje e kapaciteteve institucionale, aktivitete promovuese, advokuese apo

¹ Edhe në rastet kur propozimi vjen si bashkëpunim ndërmjet IAL-ve, një IAL-je me një biznes, apo një IAL-je me një institucion publik qendror/vendor, aplikimi bëhet nga IAL që udhëheq projektin e kërimit shkencor.

- monitoruese (kur këto përbëjnë aktivitetet kryesore të projektit dhe nuk janë pjesë e kërimit shkencor),
4. Projekt propozimi duhet të përmbajë vetëm veprimtari që lidhen me kërkimin shkencor duke përfshirë blerjen e pajisjeve dhe mjeteve laboratorike që klasifikohen në shpenzime kapitale.
 5. Në rastin e aplikimit për PTI, aplikanti i parë është një IAL në partneritet me një biznes, partneritet i cili sanksionohet me një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet tyre. Pjesë e marrëveshjes duhet të jetë bashkëfinancimi në raportin 70% financim grant nga AKKSHI dhe 30% financim nga biznesi.
 6. Aplikanti i dytë, referuar si partner nga biznesi, duhet:
 - a. të jetë i organizuar dhe të funksionojë në përputhje me legjislacionin e Republikës së Shqipërisë, specifikisht me Ligjin Nr.9901, date 14.04.2018 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”;
 - b. të shprehë qartë përfitimin nga projekti i propozuar në partneritet me kërkuesit shkencor si pjesë e IAL-së dhe të dëshmojë kapacitete në mbështetje të projektit.
 - c. të shprehe angazhimin për ofrimin e infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e aktivitetit kërkimor;
 7. Projektet PTI duhet të synojnë zhvillimin e një produkti/procesi/shërbimi të ri, ose përmirësim të dukshëm në një produkt/proces/shërbim ekzistues, me potencial tërheqës të tregut.
 8. Projekti duhet të përmbajë vetëm veprimtari që lidhen me kërkim-zhvillimin, duke përfshirë blerjen e pajisjeve, mjeteve, etj.

VII. Do të kenë përparësi:

1. Projekte të kërimit shkencor të cilat, adresojnë prioritetet strategjike kombëtare si dhe ato të Zonës Europiane të Kërimit (European Research Area - ERA)²;
2. Projekte të kërimit shkencor që kanë lidhje direkte me prioritetet strategjike sektoriale të miratuara nga Qeveria Shqiptare sipas fushave prioritare të cituar më sipër;
3. Projekte të kërimit shkencor që vijnë si bashkëpunim i dy ose më shumë IAL-ve si dhe i IAL-ve me institucione të tjera kërkimore (Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Qendrat e Transferimit të Teknologjive, Instituti i Shëndetit Publik etj);
4. Projekte të kërimit shkencor që nxisin ndërkombëtarizimin (bashkëpunime me universitetet ndërkombëtare) ose pjesëmarrje në programet evropiane të kërimit (Horizon Europe, EUREKA, Digital Europe, City mission) etc;

² Strategjia Kombëtare për Kërkimin Shkencor, Teknologjinë dhe Inovacionin 2023 – 2030.

Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the committee of the regions a Union of Equality: “Gender Equality Strategy 2020-2025”;

<https://ec.europa.eu/info/research-and-innovation/strategy/strategy-2020-2024/democracy-and-rights/gender-equality->

5. Projekte të kërkimit shkencor që vijnë si bashkëpunim i IAL-ve me institucionet publike qendrore dhe vendore për zgjidhjen e problematikave në sektorë të ndryshëm social ekonomik si dhe ato që adresojnë grupet sociale në risk me fokus të veçantë fëmijët dhe të rinjtë;
6. Projekt propozimet që mbështesin kërkimin shkencor në fushat prioritare duke përfshirë në këtë proces kërkuesit e rinj dhe studentët të doktoraturës;
7. Projekt propozime të kërkimit shkencor produkti i së ciles përbën inovacion në fushën përkatëse;
8. Projekt propozime që vijnë si bashkëpunim i universitetit dhe biznesit, të cilat synojnë risi në zgjidhjen e problematikave lidhur me proceset teknologjike, produktet, shërbimet apo proceset.

VIII. Dorëzimi i aplikimeve

1. Projekt propozimi dhe dokumentacioni i kërkuar sipas udhëzimit, së bashku me shkresën përcjellëse të titullarit të institucionit, duhet të dorëzohen në AKKSHI, në 2 kopje të shtypura dhe 1 kopje digjitale (USB).
2. Kopja digjitale duhet të përmbajë:
 - i. Formatin në word të projekt propozimit përfshirë edhe kalendarin e aktiviteteve
 - ii. Formatin në excel të buxhetit të propozuar.
 - iii. Dokumenta të tjera (kopje të origjinalit të futura në dosjen e aplikimit) të jenë vetëm në formatin pdf.
3. Aplikantët duhet të dorëzojnë dokumentacionin përmes postës zyrtare, në adresën: AKKSHI, Rruga “Naim Frashëri”, Nr.37, Tiranë, Shqipëri.
4. Afati i fundit për depozitim të aplikimeve në AKKSHI është data **11/03/2024**.

IX. Informacione të tjera

1. Aplikantët duhet t'i referohen udhëzuesit përkatës për PKKZH dhe PTI ku do të gjejnë formën e aplikimit, udhëzime dhe detaje specifike lidhur me plotësimin e dokumentacionit për aplikim (në mënyrë të veçantë për çështje si: numri i lejuar i ditëve të punës, raporti i shpërndarjes të buxhetit sipas zërave, veprimtaritë e lejuara për financim, etj).
2. Projekt-propozimet që nuk kanë dokumentacionin e plotë, kanë pasaktësi në plotësimin e formës së aplikimit apo që nuk përmbushin kriteret e përcaktuara në udhëzuesit përkatës, do të skualifikohen në fazën e shqyrtimit administrativ dhe nuk do të kalojnë për vlerësim teknik.
3. Individët të cilët janë anëtarë të grupeve të punës të projekteve në proces, të financuar në kuadër të projekteve kombëtare dhe nderkombetare (PKKZH, PTI dhe bilaterale) nuk mund të aplikojnë në këtë thirrje, nëse deri në datën e mbylljes së thirrjes (11.03.2024) nuk kanë dorëzuar pranë AKKSHI-së raportin përfundimtar të projektit në proces.
4. Kërkuesit të cilët për shkak të pozicioneve drejtuese që mbajnë në institucionet

aplikuese nuk mund të jenë pjesë e grupeve të punës në projektet e kësaj thirrjeje, për shkak të konfliktit të interesit³, të përcaktuar si të tillë në kuadrin ligjor në fuqi⁴.

5. Për sqarime më të hollësishme, lidhur me programet ose me procedurat e aplikimit, të interesuarit mund të drejtohen pranë Drejtorisë së Programeve Kombëtare në Agjencinë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit ose me e-mail në adresat: lidjana.shahinaj@nasri.gov.al gentiana.spahiu@nasri.gov.al deri në datën 29/02/2024.
6. Udhëzuesit dhe Format e aplikimit mund t'i gjeni në faqen zyrtare të AKKSHI: <http://www.nasri.gov.al>.
7. Kalendari i Thirrjes

Data e publikimit të Thirrjes për aplikim	9 Shkurt 2024
Datat e Ditëve Informativë	14,15,16 Shkurt 2024
Afati i fundit për pyetje lidhur me projektin	29 Shkurt 2024
Afati i fundit për dorëzim të aplikimeve	11 Mars 2024
Afati i fundit i vlerësimit të propozimeve	30 Prill 2024
Shpallja e fitueseve	15 Maj 2024
Nënshkrimi i kontratës	31 Maj 2024

³ "Konflikt i interesit" është gjendja e konfliktit ndërmjet detyrës publike dhe interesave privatë të një zyrtari, në të cilën ai ka interesa privatë, të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, që ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në kryerjen në mënyrë të padrejtë të detyrave dhe përgjegjësisë të tij publike.

⁴ Ligj nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike i ndryshuar me ligjin nr. 9475, datë 09.02.2006; me ligjin nr. 9529, datë 11.05.2006; me ligjin nr. 86/2012 datë 18.09.2012 dhe me ligjin nr. 44/2014 datë 24.04.2014.

Ligj nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", neni 30